



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI Nr: 1

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/141/2012
DATA E VENDIMIT: 29/02/2012

URDHËR

- (1) Në secilën prej 47 (dyzetë e shtatë) kërkesave të identifikuara në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni vendos që paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar pronësinë si paraqitës i kërkesës ose si bartës i së drejtës pronësore, sipas rastit, për pronat e kërkuara..
- (2) Në secilën prej 47 (dyzetë e shtatë) kërkesave të përmendura në paragrafin (1) më sipër, Komisioni
urdhëron që
 - (a) Paraqitësit të kërkesës apo bartësit e së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - (b) Pala përgjegjëse dhe çdo person i cili ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
 - (c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person që ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, i cili dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesët A dhe B të listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë kur paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe
- (4) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të

Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e shtatë nga 27 deri 29 shkurt 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 3,342 kërkesa për pronë bujqësore në seancën e njëzetë e shtatë nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Gjithsej 37 kërkesa kontestuese për pronë bujqësore të cila iu paraqitën Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive iu kthyen Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës. Komisioni ndërpreu shqyrtimin e 24 kërkesave për pronë bujqësore në pritje të mbajtjes së seancës dëgjimore. Përveç kësaj, Komisioni vendosi tri kërkesa të cilat ishin pezulluar më parë për mbajtjen e seancës dëgjimore. Gjithsej 3,284 kërkesa për pronë bujqësore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Me kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesat të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 47 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur Pjesa e mbetur prej 3237 kërkesash për pronë bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në dy vendimet, pikërisht vendimin KPCC/D/A/140/2012 dhe vendimin KPCC/D/A/142/2012.

9. Të 47 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronat, ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla ("Pala përgjegjëse"), ka kundërshtuar vlefshmërinë e kërkesës brenda afatit prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin nr. 03/L-079.

10 Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

1. Kërkesa kontestuese – mbrojtje e thjeshtë.

11. Në tetë kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar, ose pala që ka shprehur interes ligjor në pronën e tillë (“Pala përgjegjëse”) ose nuk ka parashtruar ndonjë mbrojtje të vlefshme në përgjigje të kërkesës ose thjesht ka pohuar se ka pasur lejen e paraqitësit të kërkesës për të shfrytëzuar pronën, pa ofruar dëshmi në mbështetje të pretendimit. Në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, Komisioni konstaton se kërkesa duhet të miratohet.

12. Në kërkesat nr. 14165 dhe 90820, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht si bashkëpronar i pronës së kërkuar. Fillimisht prona e kërkuar ishte notifikuar pasaktësisht dhe u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse, i cili e kundërshtoi kërkesën, por nuk mundi të paraqitë dokumente në mbështetje të pretendimeve të tij dhe më tej refuzoi të bashkëpunojë me Sekretarinë Ekzekutive. Gjatë notifikimit të dytë dhe të saktë, prona e kërkuar u konstatua e paузurpuar.

13. Në kërkesën nr. 44603 paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala Përgjegjëse fillimisht pohoi se e kishte blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës. Megjithatë në rrjedhën e përpunimit të kërkesës. Pala përgjegjëse sqaroi se e kishte blerë pronën nga një palë e tretë, i cili pretendon ta ketë blerë nga paraqitësi i kërkesës në vitin 1980. Pala përgjegjëse nuk mundi të paraqitë ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Paraqitësi i kërkesës e mohon ta ketë shitur pronën e kërkuar.

14. Në kërkesat nr. 48542 dhe 48543, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën, por nuk mundi të provojë mbrojtjen apo të paraqitë dokumente në mbështetje të kundërshtimit të tij.

15. Në kërkesat nr. 08458 dhe 08460 paraqitësi i kërkesës paraqiti kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjarë të mbajtësit të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht të babait të saj të ndjerë. Fillimisht prona e kërkuar është notifikuar pasaktësisht dhe palët përgjegjëse i kundërshtuan kërkesat bazuar në notifikimin e pasaktë. Palët përgjegjëse nuk i kanë tërhequr kundërshtimet e tyre edhe pse ata nuk kërkojnë të drejta ligjore për pronat e kërkuara.

16. Në kërkesën nr. 22982, Paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij të ndjerë. Prona e kërkuar u notifikua fillimisht pasaktësisht dhe pala përgjegjëse e kundërshtoi kërkesën bazuar në notifikimin e pasaktë. Pala përgjegjëse nuk e ka tërhequr kundërshtimin e tij edhe pse nuk kërkon të drejtë ligjore për pronën e kërkuar. Prona e kërkuar u gjet e uzurpuar gjatë notifikimit të dytë e të saktë. Megjithatë uzurpuesi nuk kërkoj asnjë të drejtë ligjore, por shprehu interesin e tij për blerjen e pronës së kërkuar.

2. Kërkesat kontestuese – të tjera.

17. Në 39 kërkesat e regjistruara në pjesën B të listës së bashkëngjitur, pala apo palët të cilët kanë uzurpuar pronat e kërkuara, apo pala e cila ka shprehur interes ligjor në pronat e tilla (“Palët përgjegjëse”), e kanë kontestuar vlefshmërinë e kërkesës, megjithatë, Komisioni ka arritur në përfundimin që këto kërkesa duhet të aprovohen për arsyet e dhëna më poshtë.

18. Në kërkesën nr. 01137 paraqitësi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka depozituar kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Kërkesa ka të bëjë me pronën e njëjtë që kërkohej në kërkesat me nr. 51106, 51107 dhe 51108, të cilat u depozituan personalisht nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur *inter alia* fletën poseduese në emrin e tij. Pala përgjegjëse i kundërshtoi kërkesat duke pohuar se ai i kishte blerë pronat nga një palë e tretë, i cili pretendonte se e kishte shkëmbyer pronën e kërkuar me paraqitësin e kërkesës në vitin 1985. Megjithatë, provat e paraqitura nga pala përgjegjëse nuk ndërlidhen me pronën e kërkuar.

19. Në kërkesën nr. 44085, paraqitësi i kërkesës fillimisht depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, pikërisht babait të tij. Gjatë përpunimit të kërkesës, u konstatua se mbajtësi i pretenduar i së drejtës pronësore kishte vdekur dhe paraqitësi i kërkesës se bashku me nënën dhe dy vëllezërit/motrat e tij e kishin trashëguar pronën e kërkuar. Si rezultat, Sekretaria Ekzekutive krijoi tri kërkesat me nr. 91963, 91964 dhe 91965 për pronat e nënës dhe vëllezërve/motrave të paraqitësit të kërkesës që janë kërkuar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të mbajtësve të pretenduar të së drejtës pronësore ashtu si shënohet në Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës.. Dokumenti në fjalë, u verifikua nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë. Gjatë notifikimit, prona e kërkuar u konstatua e uzurpuar nga pala përgjegjëse, i cili fillimisht i kundërshtoi kërkesat por dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij. Më pas, pala përgjegjëse e mohoi të kishte ndonjë të drejtë për pronën e kërkuar ku deklaroi se prona e tij është pranë pronës së kërkuar dhe ai nuk ka interes në atë.

c. Kërkesat nr. 17894, 17895, 17896, 90184, 90223, 92325, 47876, 47877, 47878, 49567, 49568, 49569, 49571, 49572, 49573, 49574, 30042, 30043, 30045, 30046, 30047, 30048, 30049, 30050, 30051, 30052 dhe 30053

20. Kërkesat nr. 17894, 17895, 17896, 90184, 90223 dhe 92325 u depozituan nga Senka Scepanovic në cilësinë e anëtares së bashkësisë familjare, pikërisht vajza e mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore Radusa Lalovic. Kërkesat nr. 47876, 47877, 47878, 49567, 49568, 49569, 49571, 49572, 49573 dhe 49574 u depozituan nga Milovan Lalovic në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djali i mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, Radusa Lalovic. Kërkesat nr. 30042, 30043, 30045, 30046, 30047, 30048, 30049, 30050, 30051, 30052 dhe 30053 u depozituan nga Jovanka Vukovic, po ashtu vajza e Radusa Lalovic, në cilësinë e anëtares së bashkësisë familjare, pikërisht motra e mbajtësit të së drejtës pronësore, Miladin Lalovic, i cili është i biri i mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore Radusa Lalovic. Të tri paraqitësit e kërkesës janë motra/vëllezër dhe kërkesat përfshijnë të njëjtat njësi.

21. Kërkesat nr. 30042, 30043, 30045, 30046, 30047, 30048, 30049, 30050, 30051, 30052 dhe 30053 janë paraqitur nga Jovanka Vukovic për vëllain e saj Miladin Lalovic si mbajtës i pretenduar i së drejtës pronësore në bazë të një 'vendimi trashëgimie' të lëshuar për këtë qëllim nga gjykata paralele në Serbi. Komisioni nuk konsideron se ky dokument vërteton të drejtën e trashëgimisë. Komisioni vetë, nuk ka juridiksion të zgjidhi çështje që lidhen me trashëgiminë. Rrjedhimisht kërkesat duhet të përpunohen në emër të mbajtësit të ndjerë të së drejtës pronësore, në këtë rast të nënës së paraqitësit të kërkesës, Miladin Lalovic dhe të mbajtësit filestar të pretenduar të së drejtës pronësore, pikërisht Radusa Lalovic. Paraqitësi i kërkesës ra dakord që kërkesa të përpunohet në emër të nënës së saj Radusa Lalovic.

22. Palët përgjegjëse për të këto kërkesa janë të afërm të Ismet, Ukë dhe Fatmir Malokut. Palët përgjegjëse pohojnë se i kanë blerë pronat në vitin 2004 nga Milena Djuric, përfaqësuese gjoja e autorizuar e Radusa Lalovic. Regjistrat kadastralë janë përditësuar në emrat e palëve përgjegjëse respektive.

23. Paraqitësit e kërkesës pretendoi se autorizimi i paraqitur nga Milena Djuric i cili pretendohet se i është lëshuar asaj nga mbajtësja e së drejtës pronësore Radusa Lalovic, është i falsifikuar. Komisioni vëren se autorizimi është lëshuar për këtë qëllim nga Radusa Lalovic në vitin 2001. Megjithatë certifikata e vdekjes e paraqitur nga paraqitësit e kërkesës tregon se Radusa Lalovic ka vdekur më 22 janar 1997. Paraqitësit e kërkesës deklarojnë gjithashtu se nëna e tyre ishte analfabete. Sekretaria Ekzekutive nuk mundi të verifikojë autorizimin.

24. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi palën përgjegjëse Ismet Maloku, i cili deklaroi se nuk dëshiron të bashkëpunojë me AKP-në pasi e konsideron veten pronar të pronave të kërkuara dhe se gjithashtu ia ka shitur pronat një pale të tretë. Kjo shitje e mëpasme, u konfirmua gjithashtu nga një zyrtar i Departamentit të Kadastrës në Komunën e Deçanit, i cili deklaroi se prona ishte transferuar nga Ismet Maloku tek Fatmir Maloku në vitin 2005.

25. Komisioni konsideron se nuk mund të bazohet në autorizimin e paraqitur nga palët përgjegjëse, pasi ai mban datën pas datës së vdekjes të dhënësit të pretenduar të autorizimit. Rrjedhimisht transaksioni me anë të të cilit pronat e kërkuara synohen të jenë transferuar nga Radusa Lalovic tek palët përgjegjëse nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

26. Kërkesat nr. 30867 dhe 30868 janë paraqitur nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare pikërisht nënës së tij të ndjerë. Sekretaria Ekzekutive ka konfirmuar se nëna e paraqitësit të kërkesës, Draga Moravcevic është regjistruar si pronare e pronës së kërkuar në regjistrat kadastralë. Pala përgjegjëse pohon se në të kaluarën prona ka qenë në pronësi të familjes së tij dhe se paraqitësi i kërkesës e ka përditësuar regjistrin kadastral në emër të nënës së tij bazuar në dokument të falsifikuar. Megjithatë, pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.

27. Kërkesat nr. 26070 dhe 26071 u paraqitën nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht babait të tij. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një numër dokumentesh në mbështetje të së drejtës pronësore të babait të tij duke përfshirë Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme e cila i verifikua nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë. Gjatë notifikimit, prona e kërkuar u konstatua e

uzurpuar nga pala përgjegjëse, i cili pretendon se babai i tij i kishte blerë pronat 35 vite më parë, megjithatë ato nuk ishin regjistruar kurrë në emrin e tij. Pala përgjegjëse dështoi të paraqitë dëshmi në mbështetje të pretendimeve.

28. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon se kërkesat e identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronën e kërkuar, apo pjesën e tillë siç është specifikuar në vendimin përkatës individual;
- (b) paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, në secilin rast tani nuk mund të ushtrojë të drejtën e tij apo të saj të pronësisë; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

29. Për rrjedhojë, meqë paraqitësit e kërkesave në secilën prej kërkesave të identifikuar në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur ka dëshmuar pronësinë për pronën e kërkuar, dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palës përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

3. *Kërkesat për kompensim*

30. Komisioni vëren se në disa nga kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensimin për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit, të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të hidhen poshtë.

B. *Vërejtjet përmbledhëse.*

31. Vendimet dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

32. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuar në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në rastin konkret.

33. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore, sipas rastit për të kërkuar konfirmimin e te drejtave pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part A/Pjesa A/Deo A

KPA14165	KPA22982	KPA44603	KPA48542	KPA48543	KPA90820	KPA08458
KPA08460						

Spreadsheet /Lista /Prilog

Part B/Pjesa B/Deo B

KPA01137	KPA30867	KPA30868	KPA44085	KPA51106	KPA51107	KPA51108
KPA91963	KPA91964	KPA91965	KPA17894	KPA17895	KPA17896	KPA30042
KPA30043	KPA30045	KPA30046	KPA30047	KPA30048	KPA30049	KPA30050
KPA30051	KPA30052	KPA30053	KPA49567	KPA47876	KPA47877	KPA47878
KPA49568	KPA49569	KPA49571	KPA49572	KPA49573	KPA49574	KPA90184
KPA90223	KPA92325	KPA26070	KPA26071			